

**LIGJ PER NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT PER QEVERINE E
REPUBLIKES SE MAQEDONISE**

Neni 1

Ne Ligjin per Qeverine e Republikes se Maqedonise ("Gazeta Zyrtare e Republikes se Maqedonise" numer 59/2000, 12/2003, 55/2005, 37/2006, 115/2007, 19/2008, 82/2008, 10/10, 51/11, 15/13, 139/14 dhe 196/15), neni 44 paragrafi (1), ndryshohet si vijon:

"Per organizim te zgjedhjeve te parakohshme per deputete ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise te cilat do te mbahen ne vitin 2016, Kuvendi i Republikes se Maqedonise me propozim te Kryetarit te Qeverise se Republikes se Maqedonise, njeqind dite para dites se mbajtjes se zgjedhjeve per deputete ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise zgjedh minister te Puneve te Brendshme dhe minister per Pune dhe Politike Sociale, me propozim te opozites me mandat i cili zgjat deri ne ditene shpalljes se rezultateve perfundimtare nga Komisioni Shtetedor i Zgjedhjeve per zgjedhjet e realizuara te parakohshme per deputete ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise, me cka mandati u nderpritet me fuqine e ligjit."

Ne nenin 44 paragrafi (4), ndryshohet si vijon:

"Ministri i Puneve te Brendshme mund te kryeje me se shumti 15 shkarkime ose sistemime, ne vend me te ulet ose me te larte te bartesve te pozicionit udheheqes ne ministri, ne pajtim me ligjin.

Ministri i Puneve te Brendshme mund te kryeje edhe sistemime horizontale te te punesuarve te cilet jane me propozim te tij ne numer deri 10% nga numri i sistemimeve horizontale te bazuara ne mesataren e ketyre sistemimeve ne vitet 2013 dhe 2014."

Pas paragrafit (4) shtohet paragraf i ri (5) si vijon:

"(5) Ministria e Financave dhe organet tjera te administrates shtetore dhe subjektet juridike, menjehere pas zgjedhjes se ministrit per Pune te Brendshme nga paragrafi (1) i ketij neni, i miratojne procedurat per angazhimin e personave per nevojat e kabinetit te ministrit te Puneve te Brendshme."

Paragrafi (5) behet paragraf (6).

Ne paragrafin (6) i cili behet paragraf (7) numri "(5)" zevendesohet me numrin "(6)".

Paragrafi (7) behet paragraf (8).

Neni 2

Ne nenin 46 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"Mandati i zevendesministrit plotesues zgjat nga dita e zgjedhjes se tij deri ne ditene shpalljes se rezultateve perfundimtare nga Komisioni Shtetedor i Zgjedhjeve per zgjedhjet e realizuara te parakohshme per deputete ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise te cilat do te mbahen ne vitin 2016 me cka mandati i nderpritet me fuqi te ligjit."

Neni 3

(1) Pas nderprerjes se funksionit te ministrit te Puneve te Brendshme dhe ministrit per Pune dhe Politike Sociale ne pajtim me nenin 44 paragrafin (1) te ketij ligji, zevendesministri ne Ministrine e Puneve te Brendshme dhe zevendesministri ne Ministrine e Punes dhe Politikes Sociale, e marrin kompetencen perkatesisht e ushtrojne funksionin minister i Puneve te Brendshme, perkatesisht minister i Punes dhe Politikes Sociale dite e ardhshme pas dites se shpalljes se rezultateve perfundimtare nga Komisioni Shteteror i Zgjedhjeve per zgjedhjet e realizuara te parakohshme per deputete ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise te cilat do te mbahen ne vitin 2016.

(2) Te gjitha vendimet eventuale te miratuara nga ministri i Puneve te Brendshme dhe ministri per Pune dhe Politike Sociale te zgjedhur ne pajtim me nenin 44, paragrafi (1) i ketij ligji, pas dites se shpalljes se rezultateve perfundimtare nga Komisioni Shteteror i Zgjedhjeve per zgjedhjet e realizuara te parakohshme per deputete ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise te cilat do te mbahen ne vitin 2016, jane te pavlefshme me fuqine e ligjit dhe nuk prodhojne veprim juridik.

Neni 4

Ky ligj hyn ne fuqi me dite e botimit ne "Gazeten Zyrtare te Republikes se Maqedonise", kurse do te zbatohet deri ne dite e shpalljes se rezultateve perfundimtare nga Komisioni Shteteror i Zgjedhjeve per zgjedhjet e realizuara te parakohshme per deputete ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise te cilat do te mbahen ne vitin 2016.